

Sanja Peresha – Macuka
Igor Jovanović

Sokoli Jugosllav

Mbrojtës i identitetit kombëtar





Tema

Ky modul është për Sokolin Jugosllav në periudhën e diktaturës së mbretit Aleksandër, por mund ta mbulojë periudhën prej vitit 1918 deri në vitin 1941.



Kjo temë është zgjedhur sepse Sokoli Jugosllav ishte organizata e vetme, ndërsa sot thuajse lëvizje e harruar e cila në kohën e saj ndikoi me të madhe në jetën e përditshme. Sot lëvizje të tilla nuk ka, ndërsa për nxënësit do të jetë interesante ta zgjojnë frymën e atyre viteve. Ky është gjithashtu rrëfim për idenë pansllave dhe lidhje mes kombeve, shtresave shoqërore, fesë, njerëzve të arsimuar dhe të paarsimuar.

Tema është kontroverze sepse në Mbretërinë Jugosllave lëvizja e sokolave prezantohej si organizatë universale pacifiste dhe humane e shpirtërore, por këto aspekte në atë kohë mbulohehin, ndërsa Sokolat u bënë njëra ndër shtyllat themelore të diktaturës.

Tema është relevante për tërë regjionin sepse ka të bëjë me të gjitha vendet, sepse lëvizje ishte e zhvilluar në të gjitha pjesët e Jugosllavisë ku zgjerohej unitarizmi dhe ideja e jugosllavizmit.

Rezultatet e mësimit



- Punë multiperspektive në burimet historike për të kuptuar rolin e kuptimit të lëvizjes së Sokolave në Mbretërinë Jugosllave.
- Duke shfrytëzuar burime të ndryshme, nxënësit do të jenë në gjendje në mënyrë kritike t'i vlerësojnë perspektivat e ngjarjeve historike.
- Nxënësit do të kenë mundësi t'i pranojnë mendimet e të tjerëve.



Udhëzime për mësime



45
minuta

Mësimdhënësi do t'ua lexojë hyrjen nxënësve dhe klasës do t'ia prezantojë temën e orës. Nxënësit duhet të ndahen në gjashtë grupe. Secili grup do të ketë burim, tabelë dhe pyetje, dhe do ta zgjedhë përfaqësuesin e tij. Grupet do të fitojnë udhëzime për punë. Secili grup duhet të mbështetet në analizën e rolit të pyetjeve të fituara nga burimet, që të krijojnë perceptim të përshtatshëm për lëvizjen jugosllave të sokolave. Përfaqësuesit e grupeve do t'i sqarojnë idetë deri te të cilat ka arritur grupi në përputhje me rolin e dhënë.

Grupet sipas roleve:

Grupi 1 – **Prift** nga Maribori

Grupi 2 – **Bujk** nga Varazhdini

Grupi 3 – **Student** nga Shkupi

Grupi 4 – **Avokat** nga Budva

Grupi 5 – **Mësuese** nga Sarajeva

Grupi 6 – **Amvise** nga Beogradi

HAPI 1: Hyrje dhe motivacion, mësimdhënësi e lexon hyrjen për Lëvizjen e Sokolave.

HAPI 2: Punë grupore – nxënësit punojnë në grupe të vogla të udhëhequr nga rolet: prifti, bujku, avokati, mësuesja, amvisja, studenti. Secili grup do të fitojë fragment të burimeve tekstuale dhe 10 minuta kohë që t'i hulumtojë burimet. Pas mbarimit të kohës, secili grup do ta plotësojë tabelën, në përputhje me rolin e tij (arsimin, vështrimin ndaj botës, nacionalitetit). Pas plotësimit të tabelës, nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve vijuese:

1. Sokoli në Mbretërinë Jugosllave – çka është?
2. Precizojë cakun dhe qëllimin!
3. Si kontribuoi lëvizja e sokolave në mbrojtjen e identitetit nacional jugosllav?

HAPI 3: Punë grupore – rotacioni i roleve (gjatë leximit të burimeve të reja mësimdhënësi u jep nxënësve burime të ndryshme): analizë e fotografive, plotësimi i tabelave, përgjigja e pyetjeve, prezantimi.

HAPI 4: Punë grupore – diskutimi i rolit dhe vështrimeve të ndryshme ndaj lëvizjes së Sokolave, plotësimi i tabelës 2 (shihet shtojcën).

Përgjigja e pyetjes kyçe: **Sokoli Jugosllav – organizatë rinore apo parti politike?**

Debat dhe konkluzion

Konteksti

Si lëvizje sllave kulturore dhe nacional-liberale, lëvizja e Sokolave është themeluar në Çeki në vitin 1862. Themelues i lëvizjes ishte mjeku çek Miroslav Tirsç. Qëllimet themelore të lëvizjes ishin: përhapja e vetëdijes nacionale, zhvillimi trupor dhe shpirtëror i njerëzve me anë të arsimimit dhe ushtrimeve trupore. Lëvizja e morri emrin sipas shpendit sokol – simboli i dritës, diellit, lartësisë dhe guximit. Në punëtori do të bëhet fjalë për lëvizjen e cila evoluoi nga ideja pansllave deri te promotorët e idesë së jugosllavizmit integral dhe armës së fuqishme të regjimit diktatorial.

Grupi I – roli i priftit nga Maribori

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në ruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i priftit.

Burimi 1

Letra e përbashkët e Peshkopit Katolik për Sokolat e Mbretërisë Jugosllave e shkruar në Konferencën e Peshkopëve të mbajtur në Zagreb më 17 dhjetor 1932, me urdhëresë të lexohet në të gjitha kishat më 8 janar 1933.

“Të nderuar besimtarë!

Është shumë keq që Sokoli i Mbretërisë Jugosllave, që ta largojë popullin nga kisha, i mban tubimet e veta gjatë të dielave dhe festave, edhe atë paradite dhe pasdite, dhe në atë mënyrë që anëtarësisë nuk i japin as kohë për kryerjen e detyrave fetare. Kështu prishet morali i rinisë sonë, kështu rrënohet dhe prishet feja. Për këtë arsye, besimtarë të nderuar, sipas detyrës suaj, ju paralajmërojmë më seriozisht për këtë kanosje, siç e bëmë edhe në vitin 1921, që nga fëmijët tuaj ta largoni këtë kanosje, sepse Zoti do të kërkojë përgjigje të ashpër si kujdeseshit për edukimin e drejtë të fëmijëve tuaj. Kjo vlen për aq kohë sa të qëndrojë Sokoli i Mbretërisë Jugosllave në parimet e Tirsçit, përderisa të jenë “Rrugët dhe Vaqet” rregulla për jetën dhe punën e SMJ-së, përderisa të jenë në krye të sokolave Jugosokolët e vjetër. Të qëndrojmë fortë pas fesë së prindërve tanë dhe mos të lejojmë që nga ajo fe të na largojnë sokolat, të cilët nuk duan të dinë për Shpëtimtarin tonë as për emrin tonë të ndershëm kroat (silloven).”

Politika, 16 Janar 1933.

Burimi 2

Ushtrimet e ushtrisë sonë (fotografi nga tubimi në Beograd)



Ilustrirani Slovenec, 6. 07. 1930. br. 27

1. Përshkruaje çka sheh në foto.
2. Çka të tregon fotografia?
3. A ka diçka të pazakonshme në fotografi?
4. Çka dëshiron të dish më tepër?

Grupi II – roli i bujkut nga Varazhdini

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në ruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i bujkut.

Burimi 1**Tubimi i parë i përgjithshëm i Sokolave të Mbretërisë Jugosllave**

“Lartmadhëria e Tij, trashëgimtari i fronit Petar për herë të parë në tubimin e sokolave u shfaq i veshur me veshjen e sokolave. Në mesin e shikuesve të sokolave u krijua befasi e madhe e cila u qetësua me hyrjen e anëtarëve sokola në stadium. Sokolat janë në të tre anët, rreth 3000, hynë në fushë të gjithë me hap të njëjtë. Kjo pamje ishte shumë e bukur dhe nuk ishte më pak e bukur se paraprakja, sepse është gjë e rrallë të shihet një numër i tillë i vajzave të shëndosha, të reja dhe të bukura. Në pikat e tjera morën pjesë sokolat rusë me heshta, sokolat serb të Luzhicës, anëtarët dhe anëtares me pajisje gjimnastike dhe Çeta e Fëmijëve nga Maribori”.

Varazdinske novosti, 10 Korrik 1930

Burimi 2**Sokolat e Mbretërisë Jugosllave – kthimi i Sokolave nga tubimi**

“Të martën, më datën 1 të këtij muaji pasdite i kthyen anëtarët e Shoqatës së Sokolave nga Varazhdini nga tubimi i përgjithshëm në Beograd, ku kishin shkuar më 25 qershor të këtij viti. Sokolat janë jashtëzakonisht të kënaqur me pranimin dhe të ngazëllyer flasin për tubimin. Veçanërisht u theksua fanfara e cila dëgjohej këndshëm. Gjatë zhvillimit të takimit të madhe të dielën më 29 qershor, kur kalonte fanfara e Varazhdinit pranë ulëseve mbretërore, këndohej “Varazhdinica” është përshëndetur nga një numër i madh i shikuesve. Këndimi i fanfarës tonë për zhvillimin e tubimeve u dëgjua edhe në Varazhdin sepse radioja e Beogradit e transmetoi tubimin dhe paralajmëroi ardhjen e Varazhdinasve. Sokolat u kthyen shëndoshë dhe të rrezitur mirë nga dielli. Koha ishte e mirë. Shumica e anëtarëve netët i kaluan nëpër tenda, ndërsa disa vëllezër më të vjetër banonin nëpër shtëpitë private, ndërsa anëtares ishin të vendosura nëpër shkolla. Në Varazhdin Sokolat i pritën mjaft të njohur dhe shokë me muzikë ushtarake. Nga stacioni i hekurudhor u nis aradhja deri në Sallën Sportive të Sokolave, ku përfundoi parakalimi. Gjithsejtë nga Varazhdini në Beograd gjatë ditëve kryesore të tubimit ishin rreth 160 persona”.

'Vara dinske novosti', 3 Korrik 1930

Grupi III – roli i studentit nga Shkupi

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në rruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i studentit.

Burimi 1

“Rrugët dhe caqet” (të sjella në formë të rezolutës në Kuvendin e Parë Kryesor të Lidhjes së Sokolave, të mbajtur në Beograd më 29.03.1931).

Nacionalizmi i Sokolave

“Duke synuar të kultivojë personalitete sa më të vlefshme për shoqërinë njerëzore dhe për popullin dhe shtetin e vet, Sokolat dëshirojnë ta përfshinë në radhët e tyre tërë popullin. Lëvizja e Sokolave i shërben kombit si tërësi dhe kërkon nga çdo individ që interesat e veta t'i sjellë në përputhje me interesat e përgjithshme popullore.

Ngritja e Sokolave është ngritje e popullit. Çështja e Sokolave të nacionalizmi sheh punë të pandërprerë dhe të qëndrueshme për popullin. Nacionalizmin tonë e kuptojmë si jovejtak, veprim real dhe afatgjatë për tërësinë e popullit. Çështja e Sokolave e konsideron vetëdijen nacionale jugosllave si kusht të rëndësishëm të popullit tonë të shëndetshëm. Sokolat e Mbretërisë Jugosllave janë dhe duan të mbeten pronë e tërë popullit jugosllav të një shteti të bashkuar, të pandarë dhe të lirë. Një popull, një shtet, një Sokolari”.

Politika, 19. Janar 1933.

Burimi 2**Incidenti i Trogirit**

Luanët e madhërisëm me flatra të Trogirit*, të shkatërruar me goditje çekani dhe dinamit

(*Luanët me flatra të Shën Markut – Simboli i Republikës së Venedikut)

Me qëllim të ngritjes artificiale të patriotizmit jugosllav në Dalmaci, i cili nuk është në frymën e banorëve të atjeshëm, dhe i cili krijoi urrejtje më të madhe dhe rezistencë të përditshme, autoritetet e Splitit filluan me sulmet e trashëgimisë italiane të kësaj ane nëpërmjet një çete të paguar dhe huazuar të dhunuesve. Erdhi deri te demonstrimi në bazë të ulërimit dhe ofendimit të italianëve të cilët u quajtën “Rrogëtarë të Musolinit”.

...Për qëllimet e veta e shfrytëzuan solemnitetin e “Sokolave” dhe erdhi deri te rrënim i tmerrshëm i monumenteve historike të Venedikut, të cila në mënyrë kaq të natyrshme i zbukurojnë qytetet e Dalmacisë.

...Shumica e banorëve vendas ishin të tmerruar dhe të hidhëruar për shkak të kësaj turme në shërbim të autoriteteve serbe. Pas një tentimi në Split, duke e ndjekur programin e kapëdanit të Splitit, ata në radhë e vunë Trogirin.

Pasi u bë natë, i dhanë të drejtë vetes të kenë sjellje barbare dhe ushtruan vandalizëm të cilin arsyeja e shëndoshë vështirë që mund ta kuptojë. Millefi i egër, i miratuar me sjelljen pasive të autoriteteve lokale policore, u kthye kundër përmendoreve të bukura venedikase... Në errësirën e natës së dhjetorit, luanët e Shën Markut, të cilët u respektuan me shekuj, rranë të dërmuar nën goditjet e çekanit të turmës së paguar nga Beogradi. Kështu, luanët të Dyerve të Detit dhe Dyerve të Tokës... dhe luani i madh i cili gjendej brenda sallës së qytetit – u shkatërruan me urdhër nga duart e vandalëve.

...Natën tjetër ata erdhën me fanarë dhe përdorimin e çekanëve edhe më ashpër vazhduan me shkatërrimin. Nën Selinë e Venedikut është shfrytëzuar dinamiti për shkak të zhdukjes së luanit të madh të Shën Markut. Kështu, për disa orë, të gjithë atë që Trogiri ia ofronte gjithë botës – lavdinë dhe artin e kulturës italiane – u lëndua, dëmtua dhe në masë të madhe u shkatërrua.



Divlja prototalijanska srpska mržnja, Corriere Istriano, 6 dhjetor 1931, viti. XI

Grupi IV – roli i avokatit nga Budva

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në rruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i avokatit.

Burimi 1**Incidenti i Trogirit**

Luanët e madhërisëm me flatra të Trogirit*, të shkatërruar me goditje çekani dhe dinamit (Luanët me flatra të Shën Markut – Simboli i Republikës së Venedikut)

Me qëllim të ngritjes artificiale të patriotizmit jugosllav në Dalmaci, i cili nuk është në frymën e banorëve të atjeshëm, dhe i cili krijoi urrejtje më të madhe dhe rezistencë të përditshme, autoritetet e Splitit filluan me sulmet e trashëgimisë italiane të kësaj ane nëpërmjet një çete të paguar dhe huazuar të dhunuesve. Erdhi deri te demonstrimi në bazë të ulërimës dhe ofendimit të italianëve të cilët u quajtën “Rrogëtarë të Musolinit”.

...Për qëllimet e veta e shfrytëzuan solemnitetin e “Sokolave” dhe erdhi deri te rrënimi i tmerrshëm i monumenteve historike të Venedikut, të cilat në mënyrë kaq të natyrshme i zbukurojnë qytetet e Dalmacisë.

...Shumica e banorëve vendas ishin të tmerruar dhe të hidhëruar për shkak të kësaj turme në shërbim të autoriteteve serbe. Pas një tentimi në Split, duke e ndjekur programin e kapedanit të Splitit, ata në radhë e vunë Trogirin.


Pasi u bë natë, i dhanë të drejtë vetes të kenë sjellje barbare dhe ushtruan vandalizëm të cilin arsyeja e shëndoshë vështirë që mund ta kuptojë. Mllef i egër, i miratuar me sjelljen pasive të autoriteteve lokale policore, u kthye kundër përmendoreve të bukura venedikase... Në errësirën e natës së dhjetorit, luanët e Shën Markut, të cilët u respektuan me shekuj, rranë të dërmuar nën goditjet e çekanit të turmës së paguar nga Beogradi. Kështu, luanët të Dyerve të Detit dhe Dyerve të Tokës... dhe luani i madh i cili gjendej brenda sallës së qytetit – u shkatërruan me urdhër nga duart e vandalëve.

...Natën tjetër ata erdhën me fanarë dhe përdorimin e çekanëve edhe më ashpër vazhduan me shkatërrimin. Nën Selinë e Venedikut është shfrytëzuar dinamiti për shkak të zhdukjes së luanit të madh të Shën Markut. Kështu, për disa orë, të gjithë atë që Trogiri ia ofronte gjithë botës – lavdinë dhe artin e kulturës italiane – u lëndua, dëmtua dhe në masë të madhe u shkatërrua.

Divlja prototalijanska srpska mrznja, Corriere Istriano, 6 dhjetor 1931, viti. XI

Burimi 2**Pllakatet dhe kartolinat e Sokolave**

Dušan Cvetković, Sokoli i sokolski sletovi, Miroslav, Beograd 2007.



Први Свесоколски слет Сокола Краљевине Југославије – Београд 1930. године



Први покрајински слет Сокола Краљевине Југославије у Љубљани 27 - 29. јуна 1933. године



1. Përshkruaj çka saktësisht sheh në kartolinë: përshkruaji njerëzit, veshjet, gjësendet, simbolet.
2. Cilin titull do t'ua kishit dhënë kartolinave?
3. Çka është paraqitur në mes të kartolinave, çka në skaje, çka në rend të parë dhe çka në prapavijë?
4. Cili është qëllimi i autorit? A kanë kartolinat ndonjë mesazh? A kanë ndonjë simbolikë?

Grupi V – roli i mësueses nga Sarajeva

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në rruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i mësuesit.

Burimi 1**“Rrugët dhe caqet”**

Rezolutë e Lidhjes së Sokolave e sjellë në Kuvendin e Lidhjes së Sokolave në Beograd më 29.03.1931.

“Në Organizatën e Sokolave të gjithë anëtarët janë të barabartë. Sokolat janë besnik ndaj parimeve të tyre të lirisë, barazisë dhe vëllazërisë dhe i vlerësojnë njerëzit sipas vlerave të tyre personale, dhe nuk i ndajnë sipas dallimeve klasore, shtresave dhe fiseve, e as sipas thirrjeve, pozitës shoqërore ose pronës”.

“Në mesin e Sokolave, femra konsiderohet anëtare e barabartë e shoqërisë njerëzore si meshkujt. Në organizatën e Sokolave sokolet dhe sokolat janë plotësisht të barabartë”.


“Si mjet kryesor, i drejtpërdrejtë dhe i veçantë i edukimit të Sokolave konsiderohet Zhvillimi Trupor i Sokolave sipas sistemit të Tirsçit dhe metodave të tij. Sokolat shërbejnë për qëllimin e avancimit të aftësive trupore dhe shoqërore të pjesëtarëve të tyre dhe tërë popullit, gjithashtu edhe me mjetet e tjera, të cilat janë në përputhje me parimet e përgjithshme të Sokolave”.

“Misioni i Sokolave është misin i përparimit.

Si një institucion përparimtar Sokolat beson në përparimin dhe përsosjen e njerëzimit dhe institucioneve të caktuara njerëzore. Lëvizja e Sokolave si lëvizje moderne duhet t'i kënaqë nevojat dhe synimet e kohës bashkëkohore dhe shoqërisë njerëzore, e cila e avancon mbijetesën e tij”.

Politika, 19 Janar 1933

(‘Politika’ (e përditshme nga Beogradi) e botoi më 19 janar 1933 Rezolutën e Organizatës së Sokolave që u miratua në kuvendin e mbajtur në Beograd më 29 mars 1931.

Burimi 2**Tubimi i Sokolave në Beograd**

Politika, 30.6.1930

1. Përkrahje çka sheh në fotografi?
2. Çka ju tregon kjo fotografi?
3. A ka diçka të pazakonshme në këtë fotografi?
4. Çka dëshiron të dish më tepër?

Grupi VI – roli i amvises nga Beogradi

Lexo dhe analizo burimin, plotësoje tabelën nr. 1 dhe përgjigju pyetjeve vijuese:

1. Sokoli i Mbretërisë Jugosllave – çka është kjo?
2. Përcaktoje cakun dhe qëllimin e tij!
3. Çfarë roli kishin Sokolat në rruajtjen e identitetit jugosllav?

Pas plotësimit të tabelës dhe përgjigjes në pyetjet, zgjidhni anëtarin e grupit i cili do t'i prezantojë përgjigjet tuaja nga pozita/roli i amvises.


Burimi 1

“Dhe atëherë prindërit më regjistruan për Sokol: kjo do të jetë e mirë për zhvillimin tim trupor. Kishte disa nga klasa jonë, dhe krahas kësaj edhe nxënës nga shkollat e tjera. Kishim udhëheqës shumë të mirë, të cilin duhej ta thërrasim vëlla. Quhej Vllado Lesjak, biond, sykaltër, çdoherë silllej mirë me ne dhe mendoj se të gjithë e donim. Po, ai kërkonte disiplinë, por asnjëherë nuk kishte sjellje të keqe me ne ose, mos dhëntë zoti, i vrazhdë. Mendoj se e donte punën e tij, e ndjenim që është njeri me edukim të caktuar dhe kulturë sjelljeje ndaj njerëzve. Kultivonte raport shoqëror, ndërsa kjo është themeli i të gjithë Sokolave të vërtetë”.

Branko Polić, *Vjetrenjasta klepsidra*, Durieux, Zagreb, 2007., str. 57.

Burimi 2

“I tërë Beogradi dje ishte në stadium i madh”



Politika, 29.6.1930

Burimi 3

Ushtrimet e ushtrisë sonë (fotografi nga tubimi në Beograd)



Ilustrirani Slovenec, 6. 07 1930. štev. 27

1. Përshkruaje çka sheh në fotografi?
2. Çka ju tregon kjo fotografi?
3. A ka diçka të pazakonshme në këtë fotografi?
4. Çka dëshiron të dish më tepër?

Diskutimi i roleve dhe vështrimeve të ndryshme për lëvizjen e Sokolave.

Plotësimi i tabelës 2 (shihet shtojcën).

Përgjigja e pyetjes kyçe:

Sokoli Jugosllav – organizatë rinore apo parti politike?

Debat dhe konkluzion

Shtojca:

Tabela 1

Anët pozitive (arsimi, sporti, udhëtimet, lidhja e njerëzve...)	Anët negative (indoktrinomi, nacionalizmi, dhuna...)

Tabela 2

Arsimi, sporti, letërsia	Indoktrinomi	Identiteti nacional